

KËRKESË
Nr. 3699, datë 20.3.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Jashtme shpall kërkesën për shpronësim publik të një pjese të pasurisë së paluajtshme, me adresë lagjja “5 Maji”, qyteti i Elbasanit, me të dhëna kadastrale: në pronësi të Shazimar Karaosmani, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 8525-766, datë 3.12.2013, lloji “tokë truall”, sipërfaqja 5000 (pesë mijë) m², me numër pasurie 28/28, volumni 2, faqe 226, zona kadastrale nr. 8525 Elbasan.

Në përputhje me parashikimet e nenit 15/1, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik, i ndryshuar, me anën e kësaj shpalljeje njoftojmë pronarët e truallit dhe personat e tretë të interesuar që preken nga ky shpronësim se:

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Shpronësimit ka vendosur si vijon:

Vlera e truallit objekt shpronësimi për njësi: 14, 192 lekë/m²;

Sipërfaqe trualli objekt shpronësimi: 5000 m²;

Vlera totale e shpronësimit: 70,960,000 (shtatëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Ky njoftim do të publikohet për një periudhë njëjavore. Brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit të publikimit, pronarët apo personat e interesuar, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre pranë Komisionit të Posaçëm për shpronësimet, i ngritur pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kërkesat duhet të paraqiten të shoqëruara me dokumentet përkatëse në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet e pasurive të paluajtshme për interes publik”, i ndryshuar.

ZËVENDËSMINISTRI I
PUNËVE TË JASHTME
Halil Hyseni